

URDHËR
Nr. 5, datë 19.7.2024

**PËR SHPALLJEN E “THIRRJES SË NËNTË” NË KUADËR TË PROGRAMIT
KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 6, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.4.2015, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e “Thirrjes së nëntë”, në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës me mbështetjen e institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, institucioneve të tjera publike dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore.

2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës për vitin 2024, do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për realizimin e thirrjes së nëntë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT
Bora Muzhaqi

METODOLOGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT
**NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS, THIRRJA E
NËNTË**

Në zbatim të vendimit nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, **që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.**

1. Puna përgatitore për planifikimin e nevojave

a) Institucionet e administratës shtetërore në program i komunikojnë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, personat e kontaktit për programin, numrin e praktikantëve të kërkuar dhe profilet e tyre studimore.

b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mbledh të dhënat dhe plotëson bazën e të dhënave për të gjitha institucionet e përfshira në program.

c) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit materialet për publikim në platformën *online*: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>.

d) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mban komunikimin me personat e kontaktit të të gjithë institucioneve të përfshira në program.

e) Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e tjera shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet personave të caktuar për programin, mbikëqyrin dhe udhëzojnë institucionet në varësi, për mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes së aplikantëve dhe zbatimit të programit.

2. Përgatitja dhe shpallja e procesit të aplikimit

- a) Aktivizimi i platformës *online* për aplikim: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>.
- b) Shpallja e thirrjes realizohet nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me pjesëmarrjen e institucioneve të tjera të angazhuara.
- c) Shpallja e thirrjes i dërgohet institucioneve, të cilat kanë për detyrim ta publikojnë në faqet e tyre zyrtare dhe mediat sociale.
- d) Thirrja qëndron e hapur për 38 ditë kalendarike.
- e) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mund të zgjasë afatin e aplikimit në thirrje.

3. Kriteret e aplikimit

- a) Aplikanti duhet të ketë mbushur moshën 21 vjeç deri në datën **15 shtator 2024**, si dhe të jetë në moshën deri në 26 vjeç në datën **15 shtator 2024** (fillimi i programit të praktikës).
- b) Aplikanti duhet të jetë i diplomuar në një program të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, deri në datën **1 shtator 2024**.
- c) Aplikanti nuk duhet të ketë qenë pjesë e programit në thirrjet e mëparshme, pasi qëllimi i tij është ofrimi i një përvojë kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive profesionale e të shprehive praktike, në njohje me sistemin administrativ publik.

4. Kohëzgjatja e programit

- a) Programi Kombëtar i Praktikës së Punës, thirrja e nëntë, do të zgjasë 3 (tre) muaj.
- b) Programi fillon në datën **15 shtator 2024** dhe përfundon në datën **15 dhjetor 2024**.

5. Procesi i aplikimit

- a) Aplikimi kryhet në platformën zyrtare të programit: <https://praktika.riniafemijet.gov.al>
- b) Në platformën e aplikimit publikohen profilet studimore të kërkuara nga institucionet pjesëmarrëse në program, me qëllim orientimin e kandidatëve.

6. Formati i aplikimit

Në formatin e aplikimit kërkohen të dhënat si më poshtë:

- a) të dhënat personale;
- b) studimet e përfunduara;
- c) përcaktimi i mesatares së vlerësimeve të studimeve të përfunduara, përmes të cilës aplikanti po kandidon;
- d) jetëshkrimi;
- e) letra e motivimit, në të cilën kërkohet të shpjegohet se si kjo praktikë në institucionin përkatës do të ndikonte në rritjen profesionale të aplikantit.

7. Fushata e komunikimit për thirrjen e nëntë

- a) Institucionet pjesëmarrëse në program bashkëpunojnë për publikimin e thirrjes së nëntë të programit.
- b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët organizon takime informuese me studentë, të rinj, organizatat rinore dhe/ose organizatat për të rinjtë, etj.

8. Shqyrtimi paraprak i aplikimeve

- a) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ngre një komision të posaçëm për shqyrtimin paraprak të aplikimeve.
- b) Komisioni i posaçëm shqyrton aplikimet e dorëzuara në thirrjen për plotësimin e kriterëve, si vijon:
 - dërgimi i aplikimit brenda afatit të përcaktuar;
 - plotësimi i kriterit të moshës nga aplikanti;
 - deklarimi i aplikantit si i diplomuar;
 - dorëzimi i dokumentacionit të përcaktuar në thirrje.
- c) Komisioni vendos skualifikimin e çdo aplikimi kur konstaton se ka mangësi dokumentacioni apo mospërputhje me kriteret e thirrjes.

d) Komisioni harton një raport të detajuar mbi procesin e zhvilluar dhe e paraqet pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

e) Aplikimet të cilat janë në përputhje me kriteret administrative të thirrjes, i kalohen institucioneve përkatëse për vlerësim të mëtejshëm.

9. Ngritja e komisioneve përzgjedhëse

a) Institucionet e administratës shtetërore pjesëmarrëse në program ngrenë komisionet përzgjedhëse përpara mbarimit të afatit të aplikimit.

b) Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e tjera shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktojnë nëse përzgjedhja e aplikantëve për institucionin e tyre të varësisë do të realizohet në mënyrë të qendëruar prej tyre, apo përmes komisionit përzgjedhës të ngritur pranë institucionit të varësisë.

c) Komisioni është i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë.

d) Personi i kontaktit i caktuar për programin është anëtar në komisionin përzgjedhës të institucionit.

e) Personi i kontaktit i caktuar për programin udhëzon dhe mbështet personat përgjegjës pranë institucionit të varësisë në procesin e ngritjes dhe funksionimit të komisionit përzgjedhës.

10. Komunikimi i aplikimeve

a) Personi i kontaktit i ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i dërgon, në format elektronik, aplikimet e marra në platformë, personave të kontaktit të institucioneve, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga miratimi i raportit të shqyrtimit paraprak të aplikimeve nga MSHRF-ja.

b) Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e tjera shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përcjellin aplikimet tek institucionet e tyre të vartësisë, që kanë ngritur komisione përzgjedhëse.

11. Përzgjedhja e kandidatëve fitues

Vlerësimi: Vlerësimi maksimal është 40 pikë dhe kryhet si më poshtë:

I. Vlerësimi për nivelin e diplomës:

- | | |
|-----------------------|----------|
| a) Bachelor; | 5 pikë |
| b) Master profesional | 10 pikë; |
| c) Master shkencor | 15 pikë; |

II. Vlerësimi për mesataren e notave:

- | | |
|---------|----------|
| a) 5–6 | 5 pikë; |
| b) 7–8 | 10 pikë; |
| c) 9–10 | 15 pikë. |

III. Letra e motivimit vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.

Përzgjedhja:

a) Përzgjedhja e aplikantëve mbështetet në profilet studimore të kërkuara nga institucioni, të cilat shpallen në platformën e aplikimit për thirrjen e nëntë.

b) Komisioni kryen vlerësimin e aplikantëve dhe harton listën rendore të tyre sipas pikëzimit, të ndarë sipas profileve studimore.

c) Në listë shënohen dhe kandidatët në pritje, të renditur sipas pikëzimit dhe profileve studimore, që do të zëvendësojnë kandidatët fitues në rast tërheqjeje nga programi apo verifikim parregullsie.

d) Komisioni harton listën paraprake të fituesve, sipas profileve studimore, brenda 3 (tre) ditëve pune nga administrimi i aplikimeve.

12. Njoftimi i fituesve

a) Personi i kontaktit në institucion njofton aplikantin fitues për datën e paraqitjes në institucion dhe dokumentacionin që do të dorëzohet për verifikim, brenda 2 (dy) ditëve pune nga vlerësimi i komisionit.

- b) Personi i kontaktit në çdo institucion verifikon të dhënat e deklaruara në aplikim.
- c) Aplikanti skualifikohet në rast se nga verifikimi i të dhënave rezulton të ketë bërë deklaram të rremë.
- d) Në rast skualifikimi apo tërheqjeje nga programi, personi i kontaktit njofton të renditurin në radhë sipas pikëzimit, me të njëjtin profil studimor, sipas listës së pritjes të hartuar nga komisioni.
- e) Institucioni pjesëmarrës në program, pas verifikimit të të dhënave të aplikantëve, miraton listën përfundimtare të kandidatëve të përzgjedhur dhe atyre në listë pritjeje, dhe e përcjell përmes postës elektronike, pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga përmbyllja e procesit të përzgjedhjes. Në listë pasqyrohet renditja sipas pikëzimit dhe profileve studimore të kandidatëve të përzgjedhur dhe atyre në pritje, bazuar në vlerësimin e komisionit përzgjedhës, si dhe shënimet për aplikantët e skualifikuar dhe aplikantët në listë pritjeje të rishpërndarë brenda të njëjtut sistem ministror.
- f) Institucioni pjesëmarrës në program, kur rezulton të ketë ende vende vakante, përcjell pranë ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me listën përfundimtare të fituesve, edhe kërkesën për praktikantët shtesë dhe profilet e tyre studimore.

13. Procesi i rishpërndarjes

- a) Në rast se një institucion nuk plotëson vendet e shpallura përmes aplikimeve të administruara, mund të kërkojë të mbështetet me kandidatë të tjerë nga listat e pritjes së institucioneve, brenda të njëjtut sistem ministror. Ky proces përmbyllet brenda 2 (dy) ditëve pune nga finalizimi i listave të fituesve të institucioneve.
- b) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët koordinon rishpërndarjen e aplikantëve në listë pritjeje pranë institucioneve që rezultojnë me vakanca, pas rishpërndarjes së kandidatëve brenda të njëjtut sistem ministror. Ky proces përmbyllet brenda 3 (tre) ditëve pune nga administrimi i listave të aplikantëve në pritje dhe kërkesave të institucioneve.
- c) Institucioni përzgjedh aplikantët në listë pritjeje, sipas metodologjisë së përcaktuar në pikën 11, të këtij dokumenti dhe njofton fituesit brenda 2 (dy) ditëve nga administrimi i aplikimeve shtesë.

14. Angazhimi i praktikantit në orë pune

- a) Praktikanti do të kryejë praktikën e punës pranë institucionit ku është pranuar, çdo ditë, nga e hëna deri në të premte, me kohëzgjatje 6 orë, brenda orarit zyrtar.
- b) Praktikanti, për t'u certifikuar për përfundimin me sukses të programit, duhet të ketë marrë pjesë, të paktën, në 80 % të zhvillimit të praktikës.

15. Fillimi i programit

- a) Kandidati i përzgjedhur dorëzon te personi i kontaktit në institucionin pritës, brenda 10 (dhjetë) ditëve pas fillimit të programit: jetëshkrim, fotokopjen e ID-së, kopjen e noterizuar të listës së notave të studimeve të përfunduara, kopjen e noterizuar të diplomës së studimeve të përfunduara.
- b) Pas administrimit të dokumentacionit, por jo më vonë se 14 (katërmëdhjetë) ditë kalendarike nga fillimi i programit, nënshkruhet marrëveshja midis institucionit pritës dhe praktikantit për zhvillimin e praktikës.
- c) Marrëveshja tip hartohet nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.
- d) Personi i kontaktit në çdo institucion koordinon procesin e caktimit të një mbikëqyrësi për secilin praktikant, i cili përmbush kriteret dhe detyrat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.4.2015, të ndryshuar, pikat 8 dhe 9.

16. Përfundimi i programit për thirrjen e nëntë

- a) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit dhe shpërndan pranë institucioneve pjesëmarrëse formularin tip të vlerësimit të praktikantit nga mbikëqyrësi dhe formularin tip të vlerësimit të mbikëqyrësit nga praktikanti.

b) Formularët e vlerësimit të praktikantëve nga mbikëqyrësit dhe formularët e vlerësimit të mbikëqyrësve nga praktikantët plotësohen gjatë javës së fundit të zhvillimit të programit të praktikës së punës.

c) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët harton formatin e certifikatës për praktikantët që përmbyllin me sukses programin.

d) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët verifikon me çdo institucion pjesëmarrës, listën e praktikantëve që kanë kryer me sukses programin e praktikës tremujore.

e) Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike përgatit certifikatën për çdo praktikant që përmbyll me sukses programin dhe dërgon certifikatat pranë institucioneve pjesëmarrëse.

f) Institucionet pjesëmarrëse realizojnë shpërndarjen e certifikatave të praktikantëve të tyre.